

COVID-19 PËRMBLEDHJE E UDHËZIMEVE #9

Përdorimi i maskave

REKOMANDIME PËR PERSONELIN E FARMACISË

1. Personeli i farmacisë duhet të veshë një maskë për të mbrojtur veten nga infeksioni dhe për të shmangur transmetimin e sëmundjes në rast se personeli i farmacisë infektohet.
2. Stafi i farmacisë mund të ketë nevojë të veshi një kombinim dorezash, pelerinë, maskë për fytyrën dhe / ose një mburojë të fytyrës ose syze, në varësi të detyrave që ata kryejnë dhe situatës së tyre personale.
3. Përdorimi i një maskë vetëm është e pamjaftueshme për të siguruar një nivel të duhur mbrojtjeje. Higjiena e duarve dhe e fytyrës duhet të bëhet shpesh.
4. Mbani një distancë prej 1-2 metrash nga pacientët dhe publiku për të parandaluar përhapjen nga një person në tjetrin përmes spërklave të frymëmarrjes të prodhuara kur një person i infektuar flet, kollitet ose teshtit.
5. Dezinfektoni çdo sipërfaqe që mund të preket nga pacientët ose publiku.
6. Respiratorët zakonisht nuk kërkohen të vendosen në farmacitë e rrjetit të hapur, por kërkohen nga profesionistë të kujdesit shëndetësor të përfshirë në procedurat e gjenerimit të aerosoleve.
7. Flokët e shkurtër ose flokët e lidhur, duke shmangur mjekrën e gjatë, dhe duke shmangur përdorimin e stolive, orëve dhe makiazhit, të gjitha kontribuojnë në parandalimin e infeksionit dhe përdorimin më efikas të maskave, respiratorëve dhe syzeve.

REKOMANDIME PËR PUBLIKUN

Publiku rekomandohet të mbajë një maskë në rrethanat e mëposhtme:

1. Kur kujdeseni për një person me infektion të dyshuar COVID-19.
2. Nëse ato kanë simptoma të tilla si kollitja, teshtitja ose ethe.
3. Nëse ato i përkasin grupeve me rrezik më të lartë, përfshirë të moshuarit (veçanërisht ata më të vjetër se 65 vjeç) dhe njerëzit me kushte themelore shëndetësore, kur janë në vende publike ose në prani të të tjerëve.
4. Nëse ata kanë nevojë të dalin nga shtëpia për ndonjë arsye kur janë nën karantinë (d.m.th., në izolim parandalues pas kontaktit me një rast të konfirmuar ose potencialisht pozitiv të COVID-19), për të parandaluar një transmetim të mundshëm asimptomatik ose para-simptomatik.

Maska është efektive vetëm kur përdoret në kombinim me pastrimin e shpeshtë të duarve duke i fërkuar me alkool ose sapun dhe ujë.

SI TA VENDOSNI, PËRDORNI, HIQNI DHE HIDHNI NJË MASKË

1. Para se të prekni maskën, pastroni duart duke i fërkuar me alkool ose sapun dhe ujë.
 2. Para se të vendosni maskën, inspektojeni atë për carje apo vrima.
 3. Orientojeni se cila anë është ana e sipërme (ku është shiriti metalik ose skaji i ngurtë).
 4. Sigurojeni anën e duhur të maskës (zakonisht ana me ngjyrë) që vendoset në anën e jashtme.
 5. Vendosni maskën në fytyrë. Vendosni shiritin metalik ose skajin e ngurtë të maskës në mënyrë që të marrë formën e hundës tuaj.
 6. Sigurohuni që maska të mbulojë gojën dhe mjekrën.
 7. Pas përdorimit, hiqeni maskën; hiqni llastikat nga prapa veshëve duke e mbajtur maskën larg fytyrës dhe rrobave. Shmangni prekjën e sipërfaqeve potencialisht të kontaminuara të maskës.
 8. Hidhni maskën në një kosh të mbyllur menjëherë pas përdorimit.
 9. Kryeni higjienën e duarve pasi prekni ose hidhni poshtë maskën. Fërkojini me alkool ose nëse janë të ndotura dukshëm, lajini duart me sapun dhe ujë.
- Before touching the mask, clean hands with an alcohol-based hand rub or soap and water.
Before putting on the mask, inspect it for tears and holes.

Ky dokument është përkthyer nga anglishtja nga Orion JUCIA, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë. Në rast të ndonjë divergjence midis dy teksteve, dokumenti origjinal i Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike në anglisht prevalon. E drejta e autorit mbetet ajo e Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike.

Për detaje dhe referenca mbështetëse, konsultohuni me dokumentin e plotë udhëzues në www.fip.org/coronavirus

Ky dokument bazohet në provat dhe rekomandimet në dispozicion të organizatave me reputacion në kohën e publikimit. Ai do të përditësohet kur njohuritë e reja bëhen të disponueshme. 26 Mars 2020.

